



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 3993 Prot.,  
116

Tiranë, më 31.8.2021

URDHËR

Nr. 553, datë 31.8.2021

**PËR MOS RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AGJENCIA E MBROJTJES SË PRODUCENTËVE “AMP”” PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE DHE PRODHUESVE TË FIKSIMEVE TË PARA TË FILMAVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, kërkesës së shoqërisë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve “AMP” nr. 3696 prot., datë 16.07.2021, si dhe legjislacionit në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”:

**URDHËR O J:**

1. Mos ripërtëritjen e licencës për shoqërinë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve “AMP” në administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe prodhuesve të fiksimeve të para të filmave.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

*Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.*

